REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.29083prot. Shkodër,me 16 11 .2026

N J O F T I M

Për thirrjen e mbledhjes së Këshillit Bashkiak

Të nderuar këshilltarë,

Në mbështetje të ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar dhe rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Shkodër", miratuar me Vendimin Nr.60, datë 28.12.2020, njoftoj thirrjen e mbledhjes së Këshillit Bashkiak Shkodër, në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak ditën **e Enjte** datë **26.11.2026 ora 17:00** , me rend dite si më poshtë:

Miratimi i Procesverbalit të Mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak datë, 19.10.2026 sipas ligjit Nr.8480 datë, 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", neni 16 pika 2.

1. *Projektvendim: "Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Tetor 2026".*
2. *Projektvendim: "Mbi dhënien e ndihmës financiare për dëmet e shkaktuara nga zjarri".*
3. *Projektvendim: "Për miratimin e kërkesës për transferimin e sipërfaqes 200m² të pasurisë së shoqërisë "Tregu i shitjes me shumicë fruta - perime" sh.a tek Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural".*
4. *Projektvendim: "Për dhënie pëlqimi për Pranimin e donacionit nga Fondacioni "Mane Foundation", për rikonstruksionin e ambienteve të brendshme dhe tualeteve të Shtëpisë së fëmijës 0-5 vjeç, Shkodër".*
5. *Projektvendim: "Për miratimin e zbatimit të projektit "Horizonte të përbashkëta për zhvillimin e turizmit kulturor, natyror dhe historik / Shared Horizons in Cultural, Natural and Historical Tourism", i financuar nga Bashkimi Europian nëpërmjet Programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar Mali i Zi - Shqipëri 2021-2027, në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimit (IPA III) ".*
6. *Diskutime jashtë rendit të ditës.*

Grafiku i mbledhjeve të komisioneve

Nr.	Komisione	Dita	Data	Ora
1.	Komisioni i Shërbimeve Sociale dhe Strehimit	E Martë	24.11.2026	10:00
2.	Komisioni i Rendit Publik dhe Mbrojtjes Civile	E Martë	24.11.2026	10:30
3.	Komisioni për Çështjet Ligjore	E Martë	24.11.2026	11:00
4.	Komisioni për Zhvillimin Ekonomik dhe Turizmin	E Martë	24.11.2026	11:30
5.	Komisioni i Financave, Buxhetit dhe Aseteve Publike / Komisioni i Kontrollit Financiar	E Martë	24.11.2026	12:00

Duke Ju falënderuar,

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

KRYETAR

Olldion LULI